



**BPrAL AAB**  
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSES!

# MIKROEKONOMIA

## JAVA 2

### Kërkesa, Oferta dhe Ekuilibri i tregut

Alban Asllani, Msc, (Phd Cand.)

## Java e dytë:

### Kërkesa, oferta dhe ekuilibri i tregut

- Kërkesa dhe lakorja e kërkesës
- Oferta dhe lakorja e ofertës
- Ekuilibri i tregut dhe Disekuilibri



## Hyrje

- Perderisa individet nuk mund të plotesojnë nevojat me produkte të prodhura prej tyre, ata janë të detyruar të dalin në treg, si blerës apo si shitës.
- Çdo pjesëmarrës në treg kërkon të fitojë nga këmbimi.
- Blerësit duan çmimin më të ulët të mundshëm, ndërsa shitësit çmimin më të lartë.
- Ballafaqimi në treg mes blerësve dhe shitësve përcakton çmimin dhe sasinë e tregtuar për çdo produkt.
- Kërkesa dhe oferta është një nga gjërat më të rëndësishme që Ekonomia si një profesionist i ka kontribuar botës. Kjo është një teori e persorur se si çmimet dhe nivelet e prodhimit janë të vendosura brenda tregjeve të lira.

## Kërkesa dhe lakorja e kërkeses

- Kërkesa përfaqëson sasinë e një produkti që blerësit janë të gatshëm dhe në gjendje të blejnë me çmime të ndryshme të mundshme gjatë një periudhe kohore, duke mbajtur gjithçka të tjerat të pandryshuar (ceteris paribus).
- Kërkesa përfaqëson një seri kombinimesh të cmimit dhe sasise. Pra kërkesa është një lidhje mes cmimit dhe sasise.
- Sasia e kërkuar në treg është sasia që konsumatorët do të blejnë me një çmim të caktuar gjatë një periudhe kohore.
- Kërkesa për një produkt nuk është thjeshtë një nevojë për të patur atë produkt. Kërkesa do të thotë që një konsumator të ketë nevojën për një produkt, dhe njëkohësisht të jetë i gatshëm dhe në gjendje të blejë një produkt.
- Lidhja mes cmimit dhe sasise se kërkuar shprehet nga ligji i kërkeses – I cili thotë se kur çmimet e produkteve ulen, sasia që blerësit janë të gatshëm dhe në gjendje të blejnë rritet, dhe kur çmimet rriten, sasia e kërkuar pakësohet (ceteris paribus).
- Pra, ekziston një lidhje e zhdrejtë mes cmimit dhe sasise.


# Kerkesa dhe lakorja e kerkeses

- Duhet te theksohet qe nje rritje e cmimit nuk do te thote qe nje konsumatore te kete nevojte per me pak mallra/sherbime – rritja e cmimit ul sasine e kerkuar por jo nevojten qe nje konsumatore mund te kete per nje mall/sherbim.
- Grafika dhe tabelat e ndryshme me se miri mund ta paraqesin dhe pershkruajne kerkesen, ku mund te analizojme edhe faktoret tjere te cilet ndikojne direkt ose indirekt ne kerkesen tone per mallra dhe sherbime.


# Kerkesa dhe lakorja e kerkeses

- Shembull: Kerkesa per akullore:

Çmimi i akulloreve	Sasia kerkuese per akullore (per nje jave)(000s)
10	50
20	40
30	30
40	20




# Kerkesa dhe lakorja e kerkeses




- Kjo eshte lakorja e kerkeses ne treg (ne kete shembull per tregun e akulloreve).
- Lakorja e kerkeses ka nje pjerresi negative, dhe kjo rrjedh nga ligji i kerkeses.
- Sasia dhe Cmimi jane ne perpiestim te zhdrejte – kur Sasia (Q) rritet, Cmimi (P) ulet, ceteris paribus.

# Kerkesa dhe lakorja e kerkeses



- Me anen e kesaj lakore te kerkeses ekonomistet bejne analiza te ndryshme teorike ne lidhje me ndryshimet ne treg dhe arritjen e baraspeshes (ekuilibrit) ne treg.
- Ka shume faktore tjere qe ndikojne ne kerkesen per mallra/sherbime, por cmimi eshte me i rendesishmi sepse eshte burim kryesor i informacionit rreth pamjaftuesmerise relative te burimeve dhe ndryshimit te nevojave.

## Faktoret ndikues ne Kerkese



- Kjo lakore e kerkeses mund edhe te shvendoset majtas ose djathtas – te zvogelohet apo te rritet, respektivisht. Kjo zhvendosje quhet ndryshim ne Kerkese. Ndersa levizja per gjate te njejtes lakore, quhet ndryshim ne sasine e kerkuar.
- Lakorja e kerkeses zhvendoset vetem kur fatkoret tjere (dhe jo cmimi) ndryshojne.
- Cilet jane faktoret tjere qe ndikojne tek kerkesa, perveq cmimit?

## Faktoret ndikues ne Kerkese

### • Te ardhurat e konsumatoreve

- Rritja e te ardhurave mund te shkaktoj qe konsumatoret te blejne me shume produkte.
- Rritja e te ardhurave ben qe njerezit te ndryshojne llojet e te mirave qe ata blejne. Kemi te Mira Normale dhe te Mira Inferiore.
- Per te Mirat Normale – kerkesa ndryshon ne te njejtin drejtim sikurse ndryshimi ne te ardhurat.
- Per te Mirat Inferiore – kerkesa ndryshon ne te kunderten e ndryshimit te te ardhurave.

### • Cmimet e mallrave zavendesues ose plotesues

- Nese cmimi i nje malli zavendesues rritet, kerkesa per mallin kryesore do te rritet. Shembull: Gruri dhe Misri, mund te kosniderohen si zavendesues te njeri tjetrit.
- Nese cmimi i nje malli plotesues rritet, ateher kerkesa per mallin kryesore do te ulej. Shembull: karburanti dhe automjeti – kur rritet cmimi i karburanteve, ateher mund te ulet kerkesa per automjete.

## Faktoret ndikues ne Kerkese

### • Pritjet e konsumatoreve lidhur me te ardhurat, çmimet, etj

- Njerzit pritjet qe rritin shpenzimet e tyre tani, nese ata presin nje rritje ne te ardhurat e tyre ne te ardhmen e afert.
- Rrisin kerkesen per te mira normale, dhe ulin kerkesen per te mira inferiore.
- Nese njerzit mendojne qe cmimi i nje malli do te rritet ne te ardhmen, ateher ata mund te rrisin kerkesen aktuale duke perfituar nga cmimi me i lire aktual.

### • Numri i konsumatoreve

- Kerkesa e tregut paraqitet si shume e kerkesave individuale te konsumatoreve
- Pra eshte e kuptueshme qe nje rritje ne numrin e konsumatoreve, rrite kerkesen e tregut, dhe anasjelltas.

### • Shijet e preferencat e konsumatoreve


- Per ta zgjedhur nje produkt, konsumatoret mbajne parasysh dobine qe mund te nxjerrin nga ai produkt.
- Shijet e njerezve ndryshojne, dhe me ane te shijeve edhe kerkesa ndryshon
- Kur preferenca per nje produkt forcohet me ndihmen e reklamave, kerkesa do te rritet, dhe e kunderta.

## Oferta dhe lakorja e Ofertes

- Oferta perfaqeson sasite e nje produkti qe shitesit jane te gatshem dhe ne gjendje te ofrojne per shitje me çmime te ndryshme, gjate nje periudhe kohore, ceteris paribus.
- Edhe oferta paraqet nje lidhje mes cmimit dhe sasise se mallit te ofruar.
- Kjo lidhje mund te shprehet permes ligjit te ofertes – I cili shpreh se shitesit do te ofrojne nje sasi me te madhe per shitje kur çmimet rriten, dhe e kunderta.
- Pra, ekziston nje lidhje pozitive mes sasise se ofruar dhe cmimit.


# Oferta dhe lakorja e Ofertes

Cmimi i akulloreve	Sasia e ofruar ne treg (ne jave) (000s)
10	10
20	40
30	70




# Oferta dhe lakorja e Ofertes

- Kjo eshte lakorja e ofertes ne nje treg (ne kete rast ne tregun e akulloreve)
- Pjerresia pozitive e lakores se ofertes pasqyron lidhjen pozitive mes cmimit dhe sasise – ose lidhjen mes kosatos shtese dhe cmimit.



# Faktoret ndikues ne Oferte

- Duhet te bejme dallimin mes nje ndryshimi ne sasine e ofruar (e cila eshte nje levizje per gjate te njejtës lakore te ofertes) dhe nje ndryshimi ne oferte (qe mund te shaktohet nga zhvendosjet e lakores se ofertes)
- Zhvendosjet e lakores se kerkeses shaktohen nga faktore tjere. Cilet jane ata faktore?



# Faktoret ndikues ne Oferte

## Faktoret kryesore qe ndikojne ne oferten e nje malli/sherbimi jane:

- **Çmimet e fatoreve te prodhimit**
  - Nje rritje ne çmimet e burimeve rrit kosatos e produkteve, dhe ne kushtet e cmimit te dhene ne tregun e produktit, ul oferten, dhe e kunderta
- **Teknologjia e perdorur**
  - Nje avancim ne teknologji dmth qe nje produkt mund te prodhot ne menyre me eficiente – me nje kosto me te ulet. Pra ulet kosto e prodhimit dhe rritet oferta ne treg. (Sepse rritet edhe produktiviteti)
- **Çmimet e mallrave te lidhur**
  - Oferta e nje produkti ulet, kur rriten çmimet e produkteve alternative, dhe e kunderta

# Faktoret ndikues ne Oferte

## Faktoret kryesore qe ndikojne ne oferten e nje malli/sherbimi jane:


- **Pritjet e ofruesve**
  - Nese nje prodhues pret qe kerkesa per produktin e tij do te rritet ne te ardhmen, ai/ajo do te pakesoje oferten aktuale (te rezervoj), ne menyre qe te shes me shume kur cmimi te rritet me vonë.
  - Kjo ndodh sepse nese pritjet qe çmimet e produktit te rriten ne te ardhmen, rritet kosto oportune ne shitjen e produkteve tani, sepse po humb nje rast per te shitur produktin me shtrejt ne te ardhmen kur çmimet rriten.
- **Numri i ofruesve**
  - Oferta e tregut perfaqeson shumen e ofertave individuale te prodhuesve. Pra eshte e qarte qe nese rritet numri i prodhuesve, ateher rritet edhe oferta ne treg per ate produkt.
- **Taksat, Subvensionet, dhe kuotat** e ndryshme ndaj importit dhe eksportit per mallra te ndryshme – jane gjithashtu faktore qe mund te ndryshojne oferten ne treg.

# Ekulibri i tregut

- Deri tani shqyrtuam kerkesen dhe oferten veç e veç – pra veprimet e bleresve dhe te shitesve veç e veç.
- Kemi pare qe eshte nje kontradite mes bleresve dhe shitesve. Ndersa bleresit duan çmime te uleta, shitesit duan çmime te larta.
- Tregu i ve perballe bleresit dhe shitesit – ku secili prej tyre vepron ne menyre racionale, duke krahasur perfitimet shtese me kostot shtese.
- Secili prej tyre synon qe te marre shume dhe te jap me pak.
- Per te kuptuar kete ballafaqim te shitesve dhe bleresve ne treg, ne do te bashkojme shembullin e kerkeses dhe ofertes ne nje grafike.

# Ekulibri i tregut


Cmimi i akulloreve (cent)	Sasia kerkuese (per jave) (000s)	Sasia ofertuese (per jave) (000s)
10	50	10
20	40	40
30	30	70



# Ekulibri i tregut

- Duke parë në figurën e mësipërme, ju duhet të jeni në gjendje për të parë se ekziston vetëm një çmim me të cilin sasia e kërkuar është e barabartë me sasinë e ofertës për çdo javë.
- Çmimi me 20 cent në këtë rast quhet "**çmimi i ekulibrit**". Pra eshte cmimi ku sasia e kerkuar dhe ajo e ofruar jane te barabarta.
- Sasia e shitur [40,000] me çmimin e mësipërm quhet "**sasia e ekulibrit**".
- Pra, "ekuilibri i tregut" është vendi ku lakorja e kërkesës dhe ofertës takohen. Me fjale te tjera, ekuilibri i tregut paraqet nje situatë ku bleresit dhe shitesit nuk kane arsye te ndryshojne sjelljen e tyre.
- Ne nje situatë te ekuilibrit te tregut nuk ka as kerkesë dhe as oferte te tepert, sikurse nuk ka as kerkesë dhe as oferte te manget. Bleresit dhe shitesit jane te gjithë te vegjel per te ndikuar individualisht ne çmimin e tregut.

# Teprica dhe Mungesa ne treg




# Disekuilibri ne treg

- Ne treg ekziston disekuilibri ateher kur sasia e kerkuar nuk eshte e barabarte me sasine e ofruar.
- Deri se sa tregu te jete ne nje gjendje ekuilibri, tregu eshte ne disekuilibri – pra ne treg mund te kete teprice ose mungese te ofertes ose kerkeses.
- Forcat e tregut te lire e shtyne nje situatë te disekuilibrit drejt ekuilibrit, por jo edhe gjithëher, sepse ekzistojne informacione jo te plota ne treg dhe mund te kete kosto te transportit.
- Ne tregje plotesisht konkurruese, ekuilibri mund te arrihet shume shpejt. Shembull neper ankande.
- Por shumica e tregjeve nuk funksionojne sikurse nje ankand, dhe keshtu veshtiresohet arrijta e nje ekuilibri ne treg.
- Perveq informatave jo te plota, dhe konkuresnces jo te plote ne treg, ka edhe rrethana tjera qe veshtiresojne arritjen e ekuilibrit ne treg: imponimet nga shteti ne çmime dhe ne sasine e nje malli, mosrealizimi i planave te prodhimit dhe gjendjet e nje ekuilibri te paqendrueshem.


# Ndikimi i taksave ne treg

- Ndikimi i nje takse ne mekanizmin konkurrencial:



# Çmimet tavan dhe çmimet dysheme


- Keto jane çmime qe shteti nderhyne dhe i cakton çmimet maksimale qe nje firme mund te shes produktin e saj, ose çmimin minimal qe nje firm mund te shes produktin e sajje.
- **Çmimet tavan:** Ta marrim shembull tregun e naftes:



- Kerkesa e vertete eshte ne pikën E\* - aty ku eshte ekuilibri i tregut.
- Mirepo, me vendosjen e çmimit tavan nga shteti, firmat nuk duan qe te ofrojne sasine e njejte te naftes. Ato ofrojne naftë ne pikën J.
- Pika J nuk e mbulon gjithë kerkesen, pra eshte mungese dhe mekanizmi i çmimit bllokohet.
- Zgjidhja e vetme eshte te kufizohet kerkesa dhe te behet racionimi i kerkeses duke zhvendosur D ne D'.

## Çmimet tavan dhe çmimet dysheme


- Rasti i qerese maksimale per banesa ne muaj:



- Ekuilibri i tregut do te ishte ku  $P=300$  dhe  $Q=40000$
- Nese vendoset me ligj qe qeraje mujore te jete 200 euro, ateher kerkesa per banesa do te jete 55000, kurse oferta 30000. Pra mungesa eshte 25000.
- Çmimi nuk sherben si makenizem per alokomin e banesave tek ata qe i vleresojne me shume monetarisht.
- Mjete te tjera racionimi behen te nevojshme, si p.sh. Listat e gjata te pritjes, lidhjet politike, etj.
- Rritja e qerese maksimale do ta vendoste sistemin lart pergjate lakores S deri ne piken E, gje qe do te nxishte edhe ndertimin e banesave te reja.

## Çmimet tavan dhe çmimet dysheme


- Rasti i çmimeve dysheme per produkte bujqesore:



- Qeveria mund te vendos çmime dysheme (minimume) per produkte bujqesore ne mbrojte te interesave te prodhuesve.
- Me çmimin dysheme, bujqit jane te gatshem te ofrojne nje sasi prej  $q'$  produkte, mirepo me kete çmim konsumatorët kerkojne  $q'$ .
- Krijotet teprice mes pikes J dhe K, ose  $q'$  dhe  $q''$ .
- Kete teprice shpesh qeveria e blene me çmimin e vendosur prej saj. Shume her qeveria kompenson bujqit ne nje perpjekje per te pakesuar ose eliminuar tepricen e krijuar dhe per te pakesuar oferten.
- Keto nderhyrje te qeverise ne tregje mund te zgjasin situaten e disekuilibrit ne treg.

## Çmimet tavan dhe çmimet dysheme

- Rasti i pagave minimale:



Nese qeveria e vendos me ligj qe pagat nuk duhet te jene me te uleta se sa W per nje ore pune, kjo mund te shkaktoj qe disa te mbesin pa pune.

Numri i te punesuarve nga firmat zvogelohet. Te punesuarit do te jene ne piken J.

## Literatura

- Mançellari, Hadëri (2007), "Hyrje në Ekonomi" Pegi Tiranë; Kreu 1, faqe 1-23
- Mankiw & Taylor (2010), "Ekonomiksi" UET-Press UK; Kapitulli 1, faqe 39-114
- Ligjeratat dhe Ushtrimet

PYETJE???

